

Valmire Batatina Krasniqi, PhD¹

UDC: 316.362.3-055.2:28

**GRATË DHE ROLI I TYRE NË FAMILJEN BASHKËKOHORE:
NJË QASJE ISLAME**

**ЖЕНИТЕ И НИВНАТА УЛОГА ВО СОВРЕМЕНОТО СЕМЕЈСТВО:
ИСЛАМСКИ ПРИСТАП**

**WOMEN AND THEIR ROLE IN THE CONTEMPORARY FAMILY:
AN ISLAMIC APPROACH**

Abstract

Man was created to act as God's vicegerent on Earth, so he was sent to fulfill this mission. This mission represents the greatness of man in the Revelation of God, by presenting his destiny rather than a path of suffering. The role and position of vicegerent is an honor that elevates a person from the very beginning, and this designated role is important for both men and women. This also lies in the importance of their equality as human beings and God's vicegerents on Earth, each playing their own role in society, while the family stands as a distinct institution inspired by divine wisdom. The family did not develop through the experimental processes of human evolution, nor by chance over the course of time. Indeed, it is established as a way of life, designed to help humans fulfill their mission. Any change in the structure of the family also reflects a change in society. As family roles evolve, changes in women's empowerment have reshaped gender dynamics both at home and in society. In the traditional family model, the husband is responsible for providing daily provisions, while the wife is responsible for housework and childcare. The increase in the level of education of women, activities outside the home and work in a paid job has influenced the positions, responsibilities and roles of women in society and in the family. Based on this, this study will examine the interpretation of the woman's role in the family and society in the Qur'anic perspective, her challenge between pursuing a career and fulfilling

¹ Prof. ass. Dr. Valmire Batatina Krasniqi, Faculty of Islamic Studies, Prishtina, Tafsir. Email: valmire.batatina@fsi-edu.net. ORCID No: 0000-0001-8216-169X

the traditional role of the motherhood, as well as the influence of modern feminism on the Islamic concept of the family.

Keywords: *Role of women, Family, Qur'an, Industrialization and modernization, Modern feminism.*

Hyrje

Jeta e njeriut është e lidhur me shumë aspekte të ndryshme si aktivitetet, sjelljet dhe rolet shoqërore, dhe pjesëmarrja aktive në jetë bëhet më e lehtë kur përdoren këto role në vendin e duhur. Ndaj, identiteti i individit përbëhet nga një mori rolesh të ndryshme, ku disa janë më të rëndësishme dhe kanë më shumë kuptim se të tjerat. Fjala vjen, sipas pritshmërive shoqërore për gjininë, burri ka si detyrë kryesore të sigurojë të ardhurat për familjen, ndërsa gruaja është përgjegjëse për rritjen e fëmijëve dhe ruajtjen e unitetit të jetës familjare.

Sipas perspektivës strukturore-funksionaliste, familja është një nga shtyllat kryesore që mban në këmbë rendin dhe balancën shoqërore. Duke studiuar shoqëritë që po zhvillohen dhe ato të industrializuara, ekspertët e këtij drejtimi argumentojnë se për të ruajtur stabilitetin shoqëror, është e nevojshme që rolet gjinore të ndryshojnë.² Parsons ka argumentuar se për të ruajtur rendin shoqëror, bashkëshortët në familje duhet të përmbushin role që plotësojnë njëri-tjetrin dhe janë të specializuara. Ai sugjeron se burri duhet të ketë një rol që lidhet me veprimet praktike, ndërsa gruaja duhet të fokusohet në ndjeshmëri dhe kujdes. Ky sistem rolesh krijon një hierarki gjinore.³ Duke u mbështetur në mendimin tradicional që i njeh gruas përgjegjësitë kryesore për ruajtjen e lumturisë dhe harmonisë në familje, hulumtimi është fokusuar te gratë si pjesë e popullatës objekt të studimit.

Kultura e shoqërisë në të cilën jeton një individ përcakton normat dhe pritshmëritë për sjelljen, mendimin dhe veprimet e gruas dhe burrit, duke i strukturuar ata në mënyrë sociale.⁴ Njerëzit lindin si femra ose meshkuj, por gjatë rritjes së tyre, ata zhvillojnë identitetin e vajzës ose djalit duke ndjekur rolet që shoqëria ka përcaktuar për çdo gjini. Nën ndikimin e shoqërisë dhe arsimit që marrin, fëmijët vajza dhe djem formojnë rolet dhe identitetin gjinor, duke përputhur sjelljen e tyre me pritshmëritë përkatëse. Për gratë, detyrat si punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët janë më të dukshme, ndërsa për burrat rolet në punë bëhen më të rëndësishme se ato në familje.⁵ Dallimet biologjike që ndodhin natyrshëm interpretohen dhe vlerësohen sipas kulturës në çdo shoqëri. Kjo krijon pritshmëri për atë se çfarë mund të bëjnë gratë dhe burrat,

² Erdoğan, 2008, f. 127.

³ Parsons, 1972, f. 140.

⁴ Akın&Demirel, 2003, f. 74; Üner, 2008, f. 6; Powell and Greenkouse, 2010, f. 1012.

⁵ Powell and Greenhouse, 2010, f. 1012.

çfarë të drejtash dhe fuqie ka secili, dhe kush duhet të ketë sa. Edhe pse këto pritshmëri ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën dhe brenda një shoqërie nga një grup në një tjetër, ato ndajnë një thelb të përbashkët, që është ekzistenca e asimetrisë shoqërore të bazuar në gjini dhe pabarazisë që kjo sjell.⁶ Sipas këtyre stereotipave shoqërore, pritshmëritë shoqërore për një individ varen nga gjinia e tij. Burrat pritet të jenë të fuqishëm, të sigurojnë mbijetesën e familjes dhe të ushtrojnë ndikim në rrethin e tyre, ndërsa gratë pritet të jenë të kujdesshme dhe të duruara, të menaxhojnë shtëpinë dhe të rregullojnë marrëdhëniet shoqërore.⁷ Ky fenomen duket qartë në familje, që është një institucion kryesor në shoqëri. Familja përbëhet nga individë që ndërveprojnë dhe ndikojnë në njëri-tjetrin përmes roleve të caktuara, dhe është institucioni më i rëndësishëm për përmirësimin e kënaqësisë së anëtarëve të saj në jetën e përditshme. Aktivitetet që kryhen në familje janë të shpërndara nëpër role të ndryshme mes individëve.⁸ Në familje, mënyra se si shpërndahen vendimet dhe përgjegjësitë në çështje sociale dhe ekonomike është e lidhur ngushtë me rolet që ka çdo anëtar, veçanërisht gruaja dhe burri. Vendimet sociale përfshijnë aktivitete dhe modele të ndarjes së ndjenjave mes bashkëshortëve dhe janë të rëndësishme, sepse ndikojnë në marrëdhëniet e familjes me institucione të tjera shoqërore. Këto vendime kanë rëndësi për formimin e përgjegjësisë dhe zakoneve të fëmijëve, të cilët do të ndikojnë në shoqërinë e ardhshme. Vendimet ekonomike menaxhojnë burimet dhe qëllimet e familjes dhe përfshijnë çështje që lidhen me përdorimin e burimeve.⁹ Në këtë kontekst, edhe parimet fetare luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e përgjegjësisë brenda familjes. Islami, për shembull, nuk ka kufizuar përgjegjësitë dhe të drejtat për një grup të caktuar dhe nuk ka bërë dallim mes burrave dhe grave. Të dy, burrat dhe gratë, kanë përgjegjësi dhe të drejta në kuadër të natyrshmërisë së tyre. Asnjëri nuk është më i rëndësishëm se tjetri, dhe përmbushja e detyrës nga njëri nuk e liron tjetrin nga përgjegjësia.

Lidhja midis gruas dhe hapësirës nuk mund të kufizohet vetëm tek shtëpia. Sipas Massey, gruaja që mbahet e mbyllur brenda shtëpisë, apo trupi i gruas që harrohet në jetën e përditshme, është parë si një problem më pak i rëndësishëm në shumë shoqëri, të cilat mund të jenë fetare ose jo.¹⁰ Ky fenomen nuk është i kufizuar vetëm në shoqëritë muslimane. Gjatë historisë, shumë shoqëri kanë kufizuar mundësinë e gruas për të dalë në hapësirë dhe për të qenë më të pranishme, qoftë drejtpërdrejt ose indirekt. Për shembull, në shoqëritë e lashta indiane, sipas ligjit të “Manu”, gruaja ishte e varur nga babai, burri dhe më pas djali ose një burrë tjetër i familjes, pa asnjë të drejtë të vetën. Në fund të shekullit të XIX në Britani, shoqëria nuk dëshironte që gratë të

⁶ Ecevit, 2003, f. 83.

⁷ İmamoğlu, 1991, f. 832.

⁸ Raporti familjar 2021, 2002, 17.

⁹ Şafak, 1989, 35.

¹⁰ Doreen B. Massey, *Space, Place, and Gender*, University of Minnesota Press, 1994, f. 179.

përfshihehin drejtpërdrejt në tregun e punës. U argumentua se punët e rrezikshme mund të dëmtonin shëndetin e grave, duke i shtyrë ato të kontrolloheshin dhe përfundimisht ato u mbyllën në rolin e njohur si gra shtëpiake.¹¹ Në situata të tjera, nga gratë pritej që të mos i neglizhonin punët e shtëpisë dhe jetën familjare. Ajo duhet të lindte dhe të kujdesej për fëmijët, dhe të qëndronte brenda shtëpisë. Kjo ka bërë që gruaja që mbante të gjitha detyrat e shtëpisë të përshkruhej si një “engjell shtëpie”, duke u idealizuar në këtë mënyrë, por shumë herë ky imazh nuk ka lënë hapësirë për gratë të dalin prej tij.¹² Kurse Islami e konsideron gruan si një krijesë të nderuar dhe pohon se ajo është një shtyllë e rëndësishme e familjes. Ai çrrënjosi pretendimet që ajo është një krijesë e pavlerë me status të ulët, qëllimi i krijimit të së cilës ishte vetëm për t’u shërbyer burrave dhe shpalli barazinë e gruas me burrin në çdo aspekt. Në këtë lidhje, Kur’ani thotë: *“O njerëz! Kini frikë prej Zotit tuaj, i cili ju krijoi nga një shpirt e krijoi bashkëshorten e tij prej saj, dhe nga ata shpërndau shumë burra dhe gra në tokë.”*¹³ Ky varg tregon se të dyja gjinitë janë të barabarta dhe nuk ka dallime në procesin e krijimit.

Lufta për të drejtat e grave ka kaluar nga një betejë për të drejtat e grave në një betejë midis burrave dhe grave. Po ashtu, lufta për feminitetin dhe amësinë ka krijuar një diskutim të rëndësishëm. Një ide e përhapur është që puna e padukshme e shtëpisë dhe detyrat e amësisë e bëjnë gruan të dobët dhe të pafuqishme përballë burrit. Në këtë kuadër, ka nisur një luftë ideologjike kundër konceptit të amësisë dhe institucioneve familjare. Sipas ideologjisë së feminizmit, amësia shihet si një detyrim që e mban gruan të izoluar në shtëpi. Megjithatë, është e rëndësishme që diskutimet teorike të performohen dhe të bazohen në përvojat praktike dhe ndikimet që ato kanë në jetën e grave. Synimi i punimit tonë është analizimi i teorive dhe praktikave të diskutimeve përmes argumenteve të qarta kuranore dhe përvojave të grave.

Qasja e kërkimit

Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë mënyrën e interpretimit të rolit të gruas në familje dhe shoqëri në këndvështrimin kuranor, mënyrën se si gratë e perceptojnë dhe trajtojnë aktivitetet sociale dhe rolin tradicional të nënës, si dhe ndikimi i feminizmit modern në konceptin islam të familjes. Gjatë hulumtimit është konsultuar libri hyjnor Kur’ani, analiza e rezultateve të konferencës shencore: “Gratë muslimane, arsimi joformal dhe shoqëria civile-sfidat dhe mundësitë”,¹⁴ si dhe anketa e bërë “Studimi i grave në Republikën e Kosovës

¹¹ Yüceşahin, “Toplumsal Cinsiyet ve Mekânın Karşılıklı İlişkisi: Patriyarkanın Sosyal Mekânı Örgütleyişine Dair Bir Tartışma”, f. 91.

¹² Yüceşahin, ibid, f. 90-92.

¹³ en-Nisa 4/1.

¹⁴ Gratë muslimane, arsimi joformal dhe shoqëria civile-sfidat dhe mundësitë”, Mal i Zi, 4-5 maj 2024.

(2021/2022)”¹⁵. Po ashtu punime dhe anketa të ndryshme në lidhje me pozitën e gruas në islam, si dhe sfidat dhe koncepti modern në lidhje me të dhe rolin e saj në familje. Ky kërkim, duke u mbështetur në teoritë dhe praktikën që lidhen me të drejtat dhe liritë e grave, ka për qëllim të shqyrtojë pozitën e gruas nga perspektiva e saj. Analiza është zhvilluar në mënyrë cilësore, duke u fokusuar në qëndrimet dhe analizën e tyre. Ky kërkim ka shqyrtuar rolin e gruas në kontekstin islam, marrëdhëniet mes burrave dhe grave, konceptin e feminitetit dhe amësisë, ndikimin e feminizmit në marrëdhëniet gjinore, dhe përvojat e grave, duke i trajtuar këto tema si nga një këndvështrim teorik ashtu edhe praktik.

1. Pozita e Gruas në Islam

Për të kuptuar në thellësi rolin e gruas në Islam, është e domosdoshme të studiojmë dhe kuptojmë statusin e saj gjatë periudhës së “inJORANCËS (para-Islamit), veçanërisht në territorin ku erdhi shpallja e Islamit. Edhe pse shkrimi ishte i njohur në atë kohë ai përdorej jashtëzakonisht rrallë prandaj shpesh hasim vështirësi në gjetjen e burimeve të besueshme. Për këtë arsye, ka disa sfida në studimet që lidhen me atë periudhë. Pavarësisht kësaj, veprat e poezisë dhe letërsisë, të cilat arabët i përdornin në një nivel të avancuar, na ofrojnë disa informacione. Megjithatë, duhet theksuar se burimi më i besueshëm që ndriçon atë periudhë është Kur’ani. Nëse shqyrtojmë kalimin nga shoqëritë më primitive dhe barbare në ato që kaluan në jetesë të qëndrueshme dhe arritën qytetërimin, dhe pastaj shkojmë në botën moderne dhe postmoderne, mund të kuptojmë më lehtë kuptimin e konceptit të “gruas”. Në shoqërinë arabe paraislame, struktura e familjes ishte patriarkale, ku familja dominohej kryesisht nga burrat dhe të afërmit e tyre. Të afërmit e gruas nuk konsideroheshin si pjesë e familjes. Gruaja shihej vetëm si konsumator, prandaj nuk gëzonte respekt. Ajo kishte një status të ulët, ishte e varur nga burri, shihej si një pronë dhe kishte një rol të kufizuar në shoqëri. Madje, kur lindte një vajzë, ajo konsiderohej një ngarkesë materiale dhe një burim turpi nga ana shpirtërore. Këtë realitet e përshkruan Kur’ani:

“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë fytyra e tij prishet dhe mbushet plot mlllef. Fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela, e jo dhuratë prej Zotit). Mandej (mendon) a do ta mbajë atë, ashtu i përulur, apo do ta mbulojë atë (të gjallë)në dhe. Sa i keq është ai gjykimi i tyre.”¹⁶ Në këtë ajet përmendet turpi dhe zemërimi që shpesh i çonte në varrosjen e gjallë të vajzave të tyre, por Islami thekson se ky akt i padrejtë nuk do të mbetet pa pasoja pra ata do të marrin ndëshkimin e merituar, duke e theksuar këtë përmes ajetit të mëposhtëm: *Dhe kur të pyeten*

¹⁵ 21009.pdf

¹⁶ Nahl, 16-58,59.

ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati ato janë mbytur.¹⁷ Siç është përmendur më parë, vrasja e vajzave gjatë periudhës së injorancës është konfirmuar në disa ajete të Kur'anit. Këto ajete janë të rëndësishme për të kuptuar qëndrimin e shoqërisë arabe të kohës ndaj gruas dhe ndryshimet që Islami solli në këtë aspekt. Në fakt, të gjitha krijesat janë krijuar si mashkull dhe femër, pa ndonjë dallim. Njeriu, si krijesa më e çmuar dhe më e nderuar, është përmendur në Kur'an si i barabartë me njëri-tjetrin në aspektin gjinor, ku thuhet: *“Padayshim, Ai krijoi të dyja gjinitë nga një pikë uji.”*¹⁸ Po ashtu në hadithin e Pejgamberit a.s thuhet: *“Gratë janë gjysma e plotësuar e burrave, duke formuar një tërësi së bashku.”*¹⁹ Islami jo vetëm që ka siguruar barazi për gratë në shoqëri, por gjithashtu ka vendosur një parim barazie në çështjet që lidhen me jetën pas vdekjes, duke mos bërë dallime për gratë në lidhje me shpërblimet dhe hyrjen në xhennet ku thuhet:

“Kush bën veprë të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” Të gjitha këto tregojnë se, në Islam, perceptimi i gruas është i barabartë me atë të burrit në lidhje me individin dhe të drejtat e tij. Sipas kësaj, të drejtat e jetës, pronës dhe menaxhimit të saj, barazia para ligjit dhe trajtimi me drejtësi, e drejta për të ruajtur strehimin, nderin dhe dinjitetin, liria e besimit dhe mendimit, e drejta për martesë dhe krijimin e familjes, ruajtja e privatësisë dhe paprekshmërisë së jetës private, si dhe sigurimi i jetesës janë të drejta themelore, ku nuk ka dallim midis gruas dhe burrit.

2. Roli i Gruas në Familje dhe Shoqëri

Gruaja ka luajtur gjithmonë një rol kyç në “institucionin e familjes”. Pothuajse në të gjitha fetë, përfshirë Islamin, ajo ka një pozicion të veçantë që formon bazat e familjes dhe është ndihmësja kryesore në strukturën shoqërore. Ajo është faktori që ka ndikimin më të madh në familje, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe në edukimin e brezave të ardhshëm.

Vlerat, qëllimet dhe normat e shoqërisë, si dhe mjetet e institucionalizuara që krijohen nga struktura sociale, janë të përvetësuara gjatë procesit të socializimit dhe shpesh përdoren nga individët gjatë jetës së tyre. Socializimi

¹⁷ Tekvir, 81/8,9.

¹⁸ Nexhm, 53/45-46.

¹⁹ Sulejman b. Esh'as Sixhistani, Ebu Davud, *Sunenu Ebi Davud*, Rijad: Mektebetu'l-Mearif, pa vit b., f. 94.

është burimi kryesor i fitimit dhe përvetësimit të vlerave nga ana e individit, dhe ky proces fillon në familje. Në këtë proces, roli i nënës, babait, motrave, vëllezërve, gjyshërve dhe të afërmeve është shumë i rëndësishëm. Gruaja, si nënë, ka një ndikim të madh gjatë procesit të socializimit dhe gjatë gjithë jetës së individit. Në familje, prindërit dhe të afërmit e tjerë i përcjellin individit disa forma sjelljeje, vlera themelore dhe norma shoqërore. Roli më i rëndësishëm në fazën e parë të socializimit të fëmijës është ai i nënës.²⁰ Roli i gruas si nënë ka një ndikim të jashtëzakonshëm dhe dominues në edukimin e fëmijës. Fëmijët nuk janë vetëm të ndikuar nga personalitetet e ndryshme të prindërve, por ata ndikohen gjithashtu si aktorë shoqërorë që përçojnë dhe mbartin zakonet, traditat, vlerat sociale dhe kulturore të shoqërisë ku jetojnë. Këtu përfshihen edhe aspekte të ndryshme të fesë, elementet, ritualet, besimet etj. Besimet dhe vlerat që transmetohen nga të rriturit, veçanërisht nga nëna dhe babai, gjatë periudhës së socializimit, ndikojnë tek individit dhe formojnë super-egonë e tij.²¹ Për këtë arsye, përvetësimi i normave dhe vlerave është një pjesë thelbësore e procesit të socializimit. Përveç mësimit të vlerave, më e rëndësishmja është të kuptohet si funksionon shoqëria, e cila në mënyrë indirekte i përcjell individit vlerat sociale dhe kulturore. Si pasojë, socializimi është një periudhë kyçe që mundëson që fëmija të përvetësojë, në një mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme, elemente të strukturës sociale dhe kulturore. Ky përvetësim ndihmon në ruajtjen e vazhdimësisë së kulturës së vendit të origjinës së individit, praktikave fetare dhe besimeve që ai mban.

Duke pasur një rol të rëndësishëm dhe të barabartë me burrin, gruaja mund të shërbejë si modeli më i mirë për edukimin e fëmijëve. Kur'ani nuk bën dallime në drejtësi dhe vlerë midis burrave dhe grave, duke i përfshirë të dy gjinitë në 750 ajetet që nxisin dijen dhe urtësinë – njësoj si për burrat, ashtu edhe për gratë. Muhamedi (a.s.), është i dërguar për të gjithë njerëzimin dhe ai këshilloi dhe udhëzoi burra dhe gra për mënyrën e edukimit të brezave të rinj. Në lidhje me këtë ai thekson: *“Më i miri prej jush është ai që sillet mirë me familjen e tij. Dhe unë jam më i miri për familjen time.”*²² Po ashtu, *“Të gjithë ju jeni të ngarkuar me përgjegjësi dhe secili prej jush do të mbajë përgjegjësi për ato që ka në menaxhim. Kryetari i shtetit është përgjegjës dhe do të përgjigjet për atë që ka në menaxhim. Kryefamiljari i shtëpisë është përgjegjës dhe do të përgjigjet për atë që ka në menaxhim. Zonja e shtëpisë është përgjegjëse dhe do të përgjigjet për atë që ka në menaxhim. Shërbëtori është përgjegjës për pasurinë e të zotit të tij dhe do të përgjigjet për atë që ka në menaxhim.”*²³ Këto thënie të Pejgamberit a.s. tregojnë se përgjegjësia familjare është e përbashkët: edhe gruaja, ashtu si burri, ka detyra të caktuara në këtë proces.

²⁰ Özensel, 2004, f. 33.

²¹ Güngör, 2000, f. 58.

²² Tirmidhi, “Menakib”, 63.

²³ Buhari, “İstikradh”, 20.

Kjo tregon qartë se Islami mbështet dhe promovon veprimtarinë e gruas, si në jetën familjare ashtu edhe në shoqërinë publike. Një nga të drejtat që Islami i jep gruas është edhe ruajtja e personalitetit të saj. Gruaja ka të drejtë të shprehë mendimet e saj dhe të përdorë plotësisht vullnetin e lirë. Pra gruaja, e cila nuk e mban veten të izoluar nga jeta shoqërore, tregon se ajo është një individ me personalitet që mbron veten dhe të drejtat e saj.²⁴ Gruaja në këtë kontekst mund të konsiderohet një aktore sociale po aq aktive sa një burrë, megjithatë nuk duhet harruar rolin e saj si nënë. Në të vërtetë, nëna është parë si mësuesi i parë i fesë, ndërsa babai si edukatori i parë. Prandaj, është e qartë se prindërit kanë ndikimin më të madh në edukimin e fëmijës, duke i mësuar atij parimet e fesë.

Në përmbledhje, Islami i njeh gruas një rol të dyfishtë thelbësor: jovetëm si pjesëmarrëse aktive në jetën publike, por edhe si shtyllë kryesore e socializimit familjar. Ajo shërben si modeli parësor për brezat e rinj-përmes ndërveprimit të përditshëm dhe transmetimit të vlerave fetare, duke u bërë bartëse e parë e besimit, praktikave dhe identitetit moral për fëmijët, si në fazën parësore ashtu edhe në atë dytësore të socializimit.

3. Sfida e gruas midis karrierës dhe rolit tradicional të nënës

Hyrja e gruas në botën e punës ka sjellë ndryshime demografike në përfshirjen e forcës punëtore të familjes. Po ashtu, rolet tradicionale të gruas dhe burrit në familje kanë filluar të braktisen. Modelet e marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve, ku burri punon për të siguruar jetesën dhe gruaja kujdeset për fëmijët dhe punët e shtëpisë, po ndryshojnë me të madhe. Në shoqëritë perëndimore, ka filluar të shfaqet një ndryshim drejt një modeli familjar ku të dy bashkëshortët kanë karrierë dhe punojnë në një punë të paguar, dhe ky trend po përhapet gjithashtu edhe në shoqëritë tjera.²⁵ Me rritjen e nivelit të arsimimit të gruas, është vënë re një rritje të vazhdueshme të numrit të familjeve me karrierë të dyfishtë. Në këto familje, kujdesi për fëmijët e vegjël, veçanërisht për shkak të rritjes së ngjashmërive në modelet e punës dhe pjesëmarrjes së burrave dhe grave, ka sjellë situata të reja dhe të ndryshme, duke krijuar probleme që më parë nuk ishin të pranishme në familje.

Me rritjen e prezencës së gruas në jetën shoqërore dhe profesionale, burrat përballen me frikën e humbjes së dominimit të tyre dhe vështirësinë për t'u përshtatur. Ata përpiqen të ruajnë rolin e tyre tradicional si baballarë, duke përfshirë përgjegjësinë për sigurimin e të ardhurave të familjes, ndërkohë që janë të detyruar të përshtaten me vlerat moderne të barazisë dhe ndarjes së përgjegjësisë. Kjo ka sjellë edhe pritshmërinë që burrat të angazhohen më shumë në detyrat që tradicionalisht i përkasin gruas, siç janë kujdesi për

²⁴ Gürhan, 2010, f. 74.

²⁵ Wallis-Price, 2003, f. 26.

fëmijët dhe punët e shtëpisë, dhe të tregojnë më shumë mirëkuptim, empati dhe gatishmëri për t'u pajtuar, të cilat më parë janë konsideruar karakteristika të femrës.²⁶ Në familjet ku të dy prindërit ushtrojnë profesione, domosdoshmëria e barazisë së të drejtave mes partnerëve gjatë procesit të marrjes së vendimeve është e pranishme, dhe pasi ndarja e punës nuk bazohet në gjini, konflikte të roleve mund të hasen më shpesh. Gratë shpesh përballen me më shumë konflikte të roleve në krahasim me burrat. Konflikti mes punës dhe familjes është një ndër sfidat më të mëdha për gratë që punojnë. Si nënë, për gruan prioritet ka familja. Ajo e orienton jetën dhe vendimet e saj për të përmbushur nevojat e familjes, madje herë pas here mund të heqë dorë edhe nga karriera e saj. Gratë që punojnë kanë më shumë role për të luajtur në fushën e punës dhe në atë familjare në krahasim me burrat.²⁷

Gratë që përballen me dilemat e amësisë dhe karrierës në momentet kyçe të jetës së tyre shpesh zgjedhin amësinë si prioritet. Në të gjitha shoqëritë, roli i nënës është prioritar ndaj çdo roli tjetër dhe shumë herë nuk bëhet fjalë për një zgjedhje të tillë. Kjo zgjedhje do të thotë që gruaja mund të tërhiqet për një periudhë nga jeta profesionale ose t'i dedikohet vetëm disa punëve. Me këtë largim, ajo përmbush përgjegjësitë e saj si grua dhe pritshmëritë e shoqërisë, dhe pas përfundimit të periudhës së kujdesit për fëmijët, ajo mund të rikthehet në punë. Ky pushim nga puna kërkon që gruaja, kur rikthehet, të bëjë një përpjekje të madhe për të vazhduar suksesin dhe karrierën e saj profesionale.²⁸ Përfundimisht, shumë hulumtime mbi jetën profesionale të gruas tregojnë se amësia është një profesion që zgjat gjatë gjithë jetës.²⁹ Krahas kësaj, është vërejtur një rritje e moshës mesatare të martesës, si te burrat ashtu edhe te gratë. Ky fenomen është shpjeguar me faktin se individët e shohin martesën si një pengesë për zhvillimin e karrierës së tyre.³⁰ Gratë që punojnë, njëra anë e jetës së tyre është e mbushur me një angazhim të madh në jetën profesionale, ndërsa ana tjetër e ngarkuar me përgjegjësitë e kujdesit të fëmijëve dhe detyrave të shtëpisë, çka i krijon atyre një ngarkesë të madhe. Kjo situatë shpesh shkakton lodhje dhe stres, duke rritur mundësinë që ato të përjetojnë një ndjenjë të shkatërrimit emocional, si dhe të përjetojnë një lodhje të madhe fizike dhe shpirtërore.

²⁶ Jesse&Adamsons, 2018, f. 29.

²⁷ Nayır, 2008, f. 633.

²⁸ Negiz-Tokmakçı, 2011, f. 4050.

²⁹ Nystrom-Öhrling, 2003, f. 320.

³⁰ Bayer, 2019; İnandı et al., f. 2009.

4. Ndikimi i feminizmit modern në konceptin islam të familjes në Kosovë

Feminizmi modern, dhe veçanërisht ai me origjinë perëndimore, është shfaqur si një lëvizje për të riformësuar vendin dhe të drejtat e grave në jetën shoqërore. Kjo lëvizje ka vënë në pikëpyetje rolet tradicionale gjinore dhe ka mbështetur idenë se gratë duhet të kenë të njëjtat të drejta si burrat.³¹ Në këtë kuptim, feminizmi është një lëvizje moderniste, pasi përkrah pjesëmarrjen e grave në të gjitha fushat e jetës moderne në mënyrë të barabartë me burrat dhe lufton kundër kufizimeve shoqërore dhe zinxhirëve të traditës që i pengojnë gratë të jenë individë “të lirë” në botën moderne.³² Megjithatë, ndonëse Islami ka ofruar një sistem që mbron vlerat dhe të drejtat e grave dhe u garanton atyre respekt, disa kuptime të feminizmit modern mund të bien në kundërshtim me konceptin islam të familjes. Në Islam, familja udhëhiqet nga përgjegjësitë dhe të drejtat e ndërsjella të individëve. Një nga parimet kryesore të marrëdhënieve familjare në Islam është drejtësia. Edhe pse burrat dhe gratë kanë detyra dhe përgjegjësi të ndryshme, këto dallime nuk do të thonë se njëri është më i rëndësishëm se tjetri. Ndërsa burrat mbajnë përgjegjësinë për sigurimin financiar të familjes, gratë janë përgjegjëse kryesisht për punët e shtëpisë, kujdesin për fëmijët dhe çështje të tjera të rëndësishme socio-kulturore. Islami nuk e ndalon punësimin e grave dhe madje, në disa raste, e inkurajon pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike.³³

Nën ndikimin e feminizmit modern, është rritur pjesëmarrja e grave në tregun e punës, janë krijuar mundësi të barabarta në arsim dhe është rritur statusi i tyre shoqëror, gjë që ka bërë që disa shoqëri myslimane të rishqyrtojnë rolin e gruas. Edhe pse në disa prej këtyre shoqërive të drejtat që Islami u jep grave mund të duken në kundërshtim me kuptimet e feminizmit modern, parimet themelore të Islamit mbrojnë dinjitetin dhe të drejtat e grave, por e bëjnë këtë në një mënyrë të balancuar.³⁴ Kur përcaktohen rolet brenda familjes, merren parasysh dallimet natyrore dhe përgjegjësitë e ndërsjella të individëve.

4.1. Metodologjia e vlerësimit dhe analizës së të dhënave të pyetësorit

Analiza e të dhënave është kryer duke përdorur programin SPSS për Windows 16.0, bazuar në përgjigjet e dhëna nga 107 individë në pyetësor. Për të krijuar tabela të kryqëzuara (cross-tabulation), janë marrë parasysh mosha e grave, niveli arsimor dhe statusi i punësimit në lidhje me perceptimin për

³¹ Amina Wadud (1999), *Qur'an and Woman: Rereading the Sacred Text from a Woman's Perspective*, New York: Oxford University Press, f. 40

³² A. Durakbaşa (2000), *Halide Edip Türk Modernleşmesi ve Feminizm*, Istanbul: İletişim Publications, f. 39-53.

³³ Ibnu'l-Jawzi (2011), *At-Tibb an-Nabawi*, Beirut: Dar al-Kutub al-'Ilmiyyah, f. 260.


³⁴ Bukhari, “Adab”, h. 2; Muslim, “Birr”, h. 1.

jetën familjare në kuadër të roleve gjinore. Dallimet midis pyetjeve që lidhen me perceptimin për jetën familjare në kontekstin e roleve gjinore dhe variabla të pavarur janë testuar përmes analizës Chi-Katrore (Chi-Square) për të përcaktuar nëse janë statistikisht të rëndësishme.

4.2. Të dhëna demografike

Shumica e pjesëmarrësve në pyetësor, konkretisht 80%, janë gra nga grupmosha 35-44 vjeç, ndërsa 10.1% janë nga grupmosha 45-54 vjeç dhe 10.4% nga grupmosha 18-24 vjeç. Një përqindje e lartë (90%) e grave kanë përfunduar arsimin në nivelin bachelor. Gjithashtu, nga gratë që morën pjesë në studim, 80.2% janë të punësuar, ndërsa 20% janë ende në proces studimi. Sa i përket statusit të punësimit, u vu re se shumica e grave janë të punësuar, me 75.5% që punojnë në profesione të ndryshme, që nga arsimi deri te zejtaria.

1. Grafiku i të Dhënave nga Pjesëmarrësit në Pyetësor



4.3. Procesi i vlerësimit dhe interpretimi i të dhënave nga pyetësori

a) Perceptimi për feminizmin modern

Sipas rezultateve të anketës, 48.6% e pjesëmarrësve nuk kanë njohuri të mjaftueshme rreth feminizmit modern, ndërsa 23.8% e shohin feminizmin si një lëvizje që vetëm sfidon rolet tradicionale gjinore. Kjo tregon për mungesë njohurish dhe një perceptim të kufizuar mbi feminizmin modern midis pjesëmarrësve. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe kuptimin mbi feminizmin modern, mund të zhvillohen aktivitete edukative dhe trajnime për gratë dhe shoqërinë në përgjithësi. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e njohurive dhe përmirësimin e perceptimit ndaj kësaj lëvizjeje dhe objektivave të saj.

b) Feminizmi modern dhe mësimet islame mbi familjen

Gjysma e të anketuarve (51.4%) besojnë se feminizmi modern shpesh përputhet me ide që bien ndesh me mësimet islame, ndërsa 35.2% mendojnë se feminizmi mund të jetë në përputhje me mësimet islame, por ka dallime në disa raste. Ky rezultat tregon për një perceptim të ndarë dhe njëfarë paqartësie në lidhje me lidhjen mes feminizmit modern dhe mësimëve islame për familjen. Për të rritur ndërgjegjësimin, është e rëndësishme që të diskutohet më tej roli i feminizmit modern në kontekstin e mësimëve islame. Kjo mund të bëhet përmes dialogut dhe interpretimit të mësimëve islame në një kontekst bashkëkohor, për të gjetur mundësi integrimi pa krijuar përplasje.

c) Perceptimi për rolin tradicional gjinor në familjen islame

Shumica e të anketuarve (78.1%) besojnë se gratë dhe burrat kanë role të qarta dhe të përcaktuara në Islam, dhe se ato janë natyrale. Ky perceptim tregon mbështetje për strukturën tradicionale të familjes islame, ku rolet gjinore janë të ndara dhe të përcaktuara. Nëse synohet një ekuilibër i këtyre roleve, mund të zhvillohen programe edukative që shpjegojnë se si feminizmi mund të kontribuojë në barazi dhe respekt të ndërsjellë brenda kuadrit të mësimëve islame, pa kërcënuar rolet tradicionale.

ç) Feminizmi dhe përmirësimi i marrëdhënieve familjare

Përgjigjet në këtë pyetje janë të ndara: 33.7% mendojnë se feminizmi mund të krijojë tensione dhe konflikte, ndërsa 48.1% besojnë se feminizmi mund të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve familjare nëse kuptohet dhe zbatohet në përputhje me vlerat islame. Për të arritur një rezultat më të kënaqshëm, është e nevojshme të diskutohet se si vlerat e feminizmit modern mund të përshtaten me një familje islame pa krijuar tensione. Mund të ofrohet këshillim dhe udhëzime për të ndihmuar individët dhe familjet të krijojnë një marrëdhënie harmonike, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet e të dy gjinive.

d) Feminizmi dhe ndikimi i tij në strukturën e familjes islame

Shumica e pjesëmarrësve (68.6%) besojnë se feminizmi mund të dëmtojë strukturën tradicionale të familjes islame, duke krijuar tensione dhe përçarje. Zhvillimi i aktiviteteve dhe diskutimeve ndihmon shoqërinë të kuptojë se si feminizmi modern mund të integrohet në një mënyrë që respekton strukturat tradicionale të familjes islame. Kjo mund të arrihet përmes konsultimeve dhe rishikimeve të mësimëve islame, të cilat mund të ndihmojnë në krijimin e një ekuilibri të shëndetshëm mes të dyjave.

Conclusion

Islam has granted women many rights in every aspect of life. To better understand how Islam has honored women and granted them rights suitable to their nature, it is necessary to examine where women stood before the advent of Islam and what treatments and rights they had. Clearly, when Islam arrived, women were in a very low, dehumanized position. They were often not even recognized as human beings and had few rights compared to men. In financial relations, marriage, and social life, women remained in the shadows; their personalities, ideas, and rights were often not respected. However, Islam did not make distinctions based on gender, race, or social status, but instead placed justice above all else, elevating women from the unjust position they were in and giving them the place they deserved. During the time of the Prophet (peace be upon him), despite the common perceptions of the time, women were an active and important part of society, contributing both in their professional and social lives. When examining the professions and activities women engaged in, it is noted that they participated in fields suited to their nature, such as working as seamstresses, nurses during wartime and peace, midwives, caretakers for babies, wet nurses, etc. Women also showed great interest in administration, which was another known professional opportunity.

Islam emphasizes that the family has always been a central institution for society, and its importance and continuity are essential. In traditional societies, the role of the mother was mainly to care for the education of children, while the father was recognized for his primary role in providing financial support to the family. However, in modern societies, changes in conditions and circumstances have led to transformations in the perception of family and parents. Mothers, in addition to managing the household, have also entered the professional world, contributing to the creation of a new and different family model. In dual-career families, where both parents work for pay, there has been a change in the roles and statuses of spouses. In some families which have managed to adapt to these changes, healthy relationships have been established. However, among those that have struggled to adapt, it has been harder to create healthy relationship networks.

Referencat:

Akın, A. and Demirel (2003), S. Toplumsal Cinsiyet Kavramı ve Sağlığa Etkisi, Cumhuriyet University the Journal of Medicine Faculty, vol. 25, No. 4, 3-82.

Bayer, Ali. (2019), *Eşlerarası Şiddet ve Din*, Konya: Çimke Publications.

al-Buhari, Abu Abdillah Muhammad ibn Ismail (1997), *al-Jamiu as-Sahih*, Riyadh: Darusaalam.

Doreen, B. Massey (1994), *Space, Place, and Gender*, United States: University of Minnesota Press.

Durakbaşı, A. (2000). *Halide Edip Türk Modernleşmesi ve Feminizm*, İstanbul: İletişim Publications.

Ecevit, Y. (2003), "Toplumsal Cinsiyetle Yoksulluk İlişkisi Nasıl Kurulabilir? Bu İlişki Nasıl Çatışabilir?" Cumhuriyet the Journal of Medicine Faculty, vol. 25. No. 4, 83-88.

Erdoğan T. (2008), "Toplumsal Sistemin Düzen Sağlayıcı Unsuru Olarak Cinsiyet Rolü Farklılaşması", The Journal of Social Research Türkiye 3, 123-145.

Güngör, E. (2007), *Dünden Bugünden Tarih-Kültür ve Milliyetçilik*, İstanbul: Özener Printing press.

Gürhan, Nazife (2010), "Toplumsal Cinsiyet Ve Din", Şarkiyat 4.

Ibn 'Abd al-Barr, Abu 'Amr Yusuf b. 'Abd Allah b. Muḥammad (1992), *Al-Isti'ab fī Ma'rifat al-Aṣḥab*, Beirut: Dar al-Jil.

Ibnu'l-Jawzi (2011), *At-Tibb an-Nabawi*, Beirut: Dar al-Kutub al-'Ilmiyyah.

Muslim, Abu al-Husein ibn al-Hajjaj (2007), *al-Jamiu as-Sahih*, Riyadh: Darussalam.

Nayır, Zamanlı Dilek (2008), "İşi ve Ailesi Arasındaki Kadın: Tekstil ve Bilgi İşlem Girişimcilerinin Rol Çatışmasına Getirdikleri Çözüm Stratejileri", Ege Akademik Bakış, Vol. 8. No. 2, 631-650.

Negiz, Nilüfer and Tokmakçı, Emine (2011), "Çalışma Yaşamında Kadının Tükenmişliği: Aile-İş Sosyal Yaşam Açısından Tükenmişlik Süleyman Demirel Üniversitesi Örneği." Journal of Yaşar University, vol. 24. no.6, 4041-4070.

Özensel, B. (2004), "The role of the mother in the raising of children in Turkish society: The case of Konya", Values Education Journal, vol. 2. no.6, 77-96.

Parsons, Talcott (1942), "Age and Sex in the Social Structure of the United States", American Sociological Review, vol. 7, no. 5, 604-616.

Powell G.N. and Greenhaus, J.H. (2010), "Sex, Gender, and Decisions at The Family - Work Interface", Journal of Management, vol. 36, no. 4, 1011-1039.

Sijistani, Abu Sulayman (2008), *Sunenu Ebi Davud*, Riyadh: Maktabat al-Ma'arif.

Şafak, Ş. (1989), *Ailede Rol, Fonksiyon ve Sorumluluk Dağılımı. Türk Ailesinin Sosyal ve Ekonomik Durumu Sempozyumu*, Ankara: Başbakanlık SHÇEK Press.

Tirmidhi, Abu Isa Muhammad (n.d.), *Sunan Tirmidhi*, Riyadh: Maktabat al-Ma'arif.

Wadud, A. (1999), *Qur'an and Woman: Rereading the Sacred Text from a Woman's Perspective*, New York: Oxford University Press.

Wallis, Taryn and Price, Linda (2003), "Relationship Between Work-Family Conflict and Central Life Interests Amongst Single Working Mothers", SA Journal of Industrial Psychology, vol. 29. no. 1, 26-31.

Yüceşahin, Murat (2016), "Toplumsal Cinsiyet ve Mekânın Karşılıklı İlişkisi: Patriyarkanın Sosyal Mekânı Örgütleyişine Dair Bir Tartışma", Ankara University Journal of Social